



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Njoftimi i Shkurtuar i Kontratës

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia e Tiranës
Adresa Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tel/Fax 00 355 4 22 56 799
E-mail infrastruktura.prokurime@tirana.al
Faqja e Internetit www.tirana.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”.

3. Numri i referencës së procedurës/Lotit(eve): REF- 05810-05-21-2024

Numri i referencës së lotit I REF-05817-05-21-2024

Numri i referencës së lotit II REF-05830-05-21-2024

Numri i referencës së lotit III REF-05832-05-21-2024

4. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: “Mbikqyrja e punimeve për 3 objekte të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2024” të ndarë në lote si më poshtë vijon:

- Loti I: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i rrugës Zef Serembe”.
- Loti II: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i terreneve sportive dhe muri rrethues për shkollat Mustafa Greblleshi dhe Sander Prosi”.
- Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i shkollës 9 vjecare Pjetër Budi”.

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit(FPP): 71247000-1, Mbikqyrja e punës së ndërtimit.

6. Fondi limit në total: 4,662,354.32 (katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e dy) lekë pa TVSH të ndarë në lote si më poshtë vijon:

Loti I: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i rrugës Zef Serembe” me fond limit: 660,345.38 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e dyzet e pesë pikë tridhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

Loti II: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i terreneve sportive dhe muri rrethues për shkollat Mustafa Greblleshi dhe Sander Prosi” me fond limit: 525,039.53(pesëqind e njëzet e pesë mijë e tridhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i shkollës 9 vjecare Pjetër Budi” me fond limit: 3,476,969.41(tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë dyzet e një) lekë pa tvsh.

7. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Loti I: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi i rrugës Zef Serembe”, 5 (pesë) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt.

Loti II: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi i terreneve sportive dhe muri rrethues për shkollat Mustafa Greblleshi dhe Sander Prosi”, 4 (katër) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt.

Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi i shkollës 9 vjecare Pjetër Budi”, 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt.

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 03/06/2024 Ora: 11:30.